VENDIM
Nr. 564, datë 18.9.2017

PËR SHQYRTIMIN E REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORISË SË PËRGJITHSHME, PËR FUNKSIONARIN PUBLIK Z. FREDERIK VORFI, ANËTAR I KËSHILLIT TË BASHKISË MIRDITË, NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015, "PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE"

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 18.9.2017, me pjesëmarrjen e:

Klement	Zguri	kryetar
Denar	Biba	zëvendëskryetar
Bledar	Skënderi	anëtar
Edlira	Jorgaqi	anëtare
Gëzim	Veleshnja	anëtar
Hysen	Osmanaj	anëtar
Vera	Shtjefni	anëtare,

shqyrtoi çështjen, me:

Objekt: Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për funksionarin publik, z. Frederik Fran Vorfi, anëtar i Këshillit të Bashkisë Mirditë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Bazë ligjore: Neni 23, pika 1, germa "a", i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; neni 10, pika 1, germa "d"; neni 15, pika 3, i ligjit 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; kreu V, pika 12, 13, 14, i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

KQZ-ja, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

VËREN:

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", KQZ-ja është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike, si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për subjekte, si më poshtë:

- Deputetë të Kuvendit të Shqipërisë;
- Kryeministrit apo anëtarit të Këshillit të Ministrave që nuk është deputet;
- Kryetarit të bashkisë apo këshilltarit në këshillin bashkiak.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Frederik Fran Vorfi, rezulton se është ndaluar, hetuar dhe gjykuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, nga autoritetet zvicerane, Bern me dëbim nga shteti zviceran, për 5 vjet, për veprën "Emigracion i paligjshëm", në vitin 1996.

Pas verifikimit të formularit, në përputhje me nenin 15, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 dhe kreut VI, pika 6; kreut V, pika 3, germa "b" të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, KQZ-ja me shkresën nr. 562, datë 3.2.2017, vendosi t'ia kalojë rastin për kontroll të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme.

Nga "Sektori i verifikimit të integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", me shkresën nr. 393/1 prot., datë 17.2.2017, i është kërkuar informacion për gjendjen gjyqësore Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, kurse me shkresën nr. 1083/10 ex- 16, datë 17.2.2017, i është kërkuar informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile. Nga përgjigjet e ardhura dhe verifikimet e kryera, rezulton se subjekti z. Frederik Vorfi, nuk është dënuar me vendim penal të formës

së prerë nga autoritetet gjyqësore shqiptare, këto të dhëna janë pasqyruar dhe në dëshminë e gjendjes gjyqësore nr. 11, datë 22.2.2017, përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, referuar së cilës, subjekti rezulton "I padënuar". Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 1418/1, datë 27.2.2017, ka vënë në dispozicion të dhënat personale të subjektit, nga të cilat rezulton se z. Frederik Vorfi ka të njëjtat gjeneralitete, të cilat i ka deklaruar në formularin e vetëdeklarimit.

Me shkresën nr. 393/3, datë 6.9.2017, Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë, Sektori i Verifikimit të Integritetit, i ka dërguar në KQZ, vendimin e rezultatit të verifikimit për z. Frederik Vorfi, me detyrë anëtar i Këshillit të Bashkisë, Mirditë.

KQZ-ja, refereuar nenit 15 të ligjit nr. 138/2015, vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, është institucioni kompetent për shqyrtimin e rezultateve të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për z. Frederik Vorfi.

Pas rezultatit të verifikimit për z. Frederik Vorfi, me detyrë anëtar i Këshillit të Bashkisë, Mirditë, referuar pikës 12 dhe 13, kreu V i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", KQZ-ja vlerëson se për sa u përket procedurave të ndjekura për rezultatet e verifikimit, në lidhje me të dhënat në formularin e deklarimit, referuar pikës 1 dhe 2, të nenit 8, të ligjit nr. 138/2015 dhe pikës 5, të kreut V të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, është kompetencë e Prokurorisë së Përgjithshme.

Në këtë fazë të procesit, KQZ-ja duhet të kryejë procedurat e mëposhtme:

I. Të shqyrtojë nëse janë evidentuar nga procesi i verifikimit të dhëna që përfshihen brenda sferës së ndalimeve të parashikuara nga neni 2, i ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Neni 2, i ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", parashikon: "Nuk mund të kandidojnë dhe as të zgjidhen deputetë në Kuvendin e Shqipërisë, kryetar bashkie apo këshilltar në këshillin bashkiak dhe, në çdo rast, nuk mund të marrin një funksion me votim nga Kuvendi, përfshirë funksionin e Kryeministrit apo të anëtarit të Këshillit të Ministrave apo me votim nga këshillat bashkiakë ose të qarkut, personat të cilët janë dënuar me burgim me vendim të formës së prerë, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për: a) kryerjen e veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë vepër penale, sipas neneve 73, 74, 75, 76, 77, 78, 78/a, 79, 79/a, 79/b dhe 79/c, 86, 87, 88, paragrafi i dytë, 89/a, 100, 101, 102, 102/a, 103, 104, 105, 106, 109, 109/b, 109/c, 110/a, 111, 114, 128/b, 135, 136, 140, 141, 143/a, 215, 216, 217, 218, 219, 220, 221, 222, 230, 230/a, 230/b, 230/ç, 231, 232, 232/a, 232/b, 233, 234, 234/a, 234/b, 278, paragrafi i parë, i pestë e i gjashtë, 278/a, 282/a, 283, 283/a, 284/a, 287, i lidhur me kryerjen e një krimi të parashikuar në këtë paragraf, 333, 333/a, të Kodit Penal;

b) ..."

Nga shqyrtimi i procesit të verifikimit të kryer nga Prokuroria e Përgjithshme, rezulton se:

z. Frederik Vorfi është dënuar për vepër penale "Shkelje të ligjit mbi narkotikët", parashikuar në Pjesën e Posaçme të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, kreu VIII, seksioni III, konkretisht, neni 283, "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve".

Vepra penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve" përfshihet, në fushën e ndalimit të ushtrimit të funksionit, të parashikuar të nenit 2, pika 1, germa "a", të ligjit nr. 138/2015. Sipas parashikimit ligjor të këtij neni përfshihen në këtë pikë personat e dënuar me vendim të formës së prerë brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për kryerjen e veprave penale të përfshira në kreun VIII, seksionin III, përkatësisht, nenin 283 të Kodit Penal, "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve".

Z. Frederik Vorfi është dënuar me vendimin nr. 98/0153 akti, datë 12.2.1998 nga Gjykata Rajonale Bern-Lupen:

1. Shkelje të ligjit mbi narkotikët në bashkëpunim me marrjen, posedimin e 48.3 gramë heroinë dhe shitjen e 18.8 gramë heroinë;

2. Shkelje e ligjit të trafikut, duke përdorur pa autorizim një biçikletë;

3. Shkelje e ligjit mbi transportin, duke udhëtuar në mënyrë të përsëritur me tren pa biçikletë të vlefshme, është dënuar me 9 muaj burg, me kusht për 2 vjet dhe ndalim hyrjeje në territorin zviceran, për 5 vjet. Vepra penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve" parashikohet nga neni 2, pika 1, germa "a", e ligjit nr. 138/2015.

Vepra penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve" e parashikuar nga Kodi Penal Shqiptar, në nenin 283, përfshihet, në fushën e ndalimit të ushtrimit të funksionit, të parashikuar nga neni 2, pika 1, germa "a", e ligjit nr. 138/2015.

II. Sipas pikës 13, kreu V, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, nëse ekzistojnë të dhëna që përfshihen brenda sferës së ndalimeve, të parashikuara nga nenin 2, të ligjit nr. 138/2015, KQZ-ja verifikon nëse ato përfshihen brenda periudhës së ndalimit të përcaktuar në nenin 4, të ligjit nr. 138/2015.

Neni 4, i ligjit nr. 138/2015

1. Për personat që parashikohen në shkronjën "a", të pikës 1, të nenit 2, të këtij ligji, ndalimi për kandidim, zgjedhje apo ushtrim të mandatit zgjat gjatë gjithë jetës.

2. ...

3. ...

Referuar nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 138/2015, periudha e ndalimit për ushtrimin e funksionit për personat e dënuar për veprën penale të parashikuar nga neni 2, pika 1, germa "a", e këtij ligji, zgjat gjatë gjithë jetës. Z. Frederik Vorfi është dënuar me vendim të formës prerë nga Gjykata Rajonale Bern-Lupen, për veprën penale, "Shkelje të ligjit mbi narkotikët", të parashikuar nga Kodi Penal Shqiptar, në nenin 283. "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", e përfshirë në nenin 2, pika 1, germa "a", të ligjit nr. 138/2015. Në këto kushte z. Frederik Vorfi është brenda periudhës për ndalimin e ushtrimit të funksionit.

Z. Frederik Vorfi, në lidhje me të dhënat për dënim për kryerjen e veprës penale, "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve" është në kushtet e ndalimit të ushtrimit të funksionit, sipas parashikimeve të nenit 2, pika 1, germa "a", nenit 4, pika 1, të ligjit 138/2015.

Vepra penale e kryer dhe dënimi i caktuar ndaj z. Frederik Vorfi, përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2, pika 1, germa "a", të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", pasi është dënuar me 9 (nëntë) muaj burg, për shkelje të ligjit mbi narkotikët, në bashkëpunim me marrjen, posedimin e 48.3 gramë heroinë dhe shitjen e 18.8 gramë heroinë", që, si vepër penale është e parashikuar në Pjesën e Posaçme të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, kreu VIII, seksioni III, konkretisht, neni 283, "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve". Vepra penale parashikohet si ndalim në pikën 1/a, të ligjit nr. 138/2015.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1, germa "a", të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; nenin 10, pika 1, germa "d"; nenin 14; nenin 15, pika 3, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; kreun V, pika 12, 13, 14 të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike",

VENDOSI:

1. Të shpallë të pavlefshëm mandatin e anëtarit të Këshillit të Bashkisë Mirditë, z. Frederik Vorfi.

2. Ky vendim i njoftohet menjëherë Kryeministrit.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 45 ditëve, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Klement Zguri